



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija-
Department of Free

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPSDPLS.nr. 12/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Naim Meholli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Driton Govori, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga me seli në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.2251/25, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Mimoza Blakaj, pala ankuese i përfaqësuar nga , personalisht Përmbaruesi Privat me datën 30.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET ankesa e paraqitur nga pala ankuese, me seli në , si e pa bazuar.

II. Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr.2251/25.

A r s y e t i m

Me datën 11.06.2025, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbaruesit Privat, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën dëgjimore, me të cilën pretendon i se asnjëherë nuk e ka pranuar urdhrin përmbarimor, dhe sipas palës ankuese nuk është tentuar përmbaruesi të ja dorëzoj shkresat e lëndës palës ankuese gjegjësisht nuk janë dorëzuar propozimi për përmbarim me urdhër në adresën e debitorit, pastaj ka proceduar me urdhër për

transfer përkund njoftimit nga debitori për parregullsi në procesin e dorëzimit të urdhrit përmbartimor, i ka mohuar debitorit në asje në shkresat e lendes, ku është cenuar e drejta e ushtrimit të mjeteve juridike, tutje pala ankuese pretendon se përmbartuesi ka shkel neni 341 par 1 pika 1.3 të dorëzimit të urdhrit përmbartimore dhe piken 1.4 ta identifikoj palën debitorë po ashtu pala ankuese pretendon se nuk janë lëshuar faturat për veprimet e ndërmarra apo mjetet e tërhequra. Mëtej pala ankuese pretendon se lidhur me procedurën përmbartimore që është iniciuar ndaj tij, është njoftuar vetëm kur ju kanë bllokuar llogaria bankare, me urdhrin e përmbartuesit privat. I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndermirën masa ndaj përmbartuesi privat.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbartuesit privat, lidhur me veprimet përmbartimore për këtë lëndë dhe mbetet në tërësi pran raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 30.09.2025.

Përmbartuesi Privat, në seancën dëgjimore të datës 30.09.2023, ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjëse për asnjë nga veprimet e ndërmarra përmbartimore në këtë rast duke shtuar se titulli përmbartimor në këtë rast është Aktvendimi i Gjykatës PP.nr.114/2022 i dt.23.12.2022, ku pas lejimit të urdhrit komunikimi është zhvilluar sipas adresës ne propozim dhe adresës në ARBK, dhe meqenëse është konstatuar nga dorëzuesi i postes se adresa është jo e plot e kemi afishuar shkresën me dt.05.05.2025 në tabelën e shpalljeve dhe me dt.26 maj është bere bllokimi dhe me dt.30 maj është bere urdhri për transfer. I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa.

Komisioni Disiplinor, pasi vlerësoi pretendimin e palës ankuese, pasi që çështja është rikthyer në rishqyrtim dhe rivendosje sipas aktgjykimit të lartcekur dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore në këtë rast erdhi në përfundim se përmbartuesi lëndor, nuk është përgjegjës për veprimet e ndërmarra përmbartimore. Kjo nga shkak se me asnjë provë shkresore në shkresat e lëndës nuk mund të provohet se përmbartuesi privat, me qëllim të inicimit të procedurës përmbartimore, ka ndërmarrë veprime përmbartimore që nuk janë në harmoni me ligjin.

Me nenin 367, të Ligjit të Procedurës Përmbartimore(LPP), janë përcaktuar, shkeljet disiplinore dhe atë: *1. Shkeljet disiplinore munden të jenë si në vijim:*

1.1. nëse përmbartuesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;

1.2. nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbartuesi privat nuk i përmbahet ligjit;

1.3. nëse përmbartuesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;

1.4. nëse përmbartuesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;

1.5. nëse përmbartuesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;

1.6. nëse përmbartuesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;

1.7. nëse përmbartuesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;

1.8. nëse përmbartuesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;

1.9. nëse përmbaruesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbarimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;

1.10. shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera;

1.11. nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Nga interpretimi i dispozitës së lartcekur dhe nga shkresat e lëndës nuk rezulton se përmbaruesi privat ka rënë ndesh me ndonjërin nga pikat e lartcekura disiplinore, ngase i njëjti e ka lejuar urdhrin përmbarimor në bazë të të dhënave dhe shkresave të lëndës. Nuk është i qëndrueshëm pretendimin i palës ankuese së përmbaruesi privat nuk ka tentuar që t'ia dërgon urdhrin përmbarimor në adresën e saktë të debitorit. Për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton se përmbaruesi privat, ka tentuar që përmes Postës së Kosovës, me rekomandë ta dërgon urdhrin përmbarimor tek debitori – pala ankuese, në adresën që e kishte pala ankuese në ARBK ku në fletkthesen postes është shkruar saktë adresa sipas të dhënave në ARBK, mirëpo nga posta është bërë konstatimi se marrësi i dërgesës është në adresë të pa saktë. Më pastaj përmbaruesi privat, ka vendos që i tërë komunikimi me debitorin tani palë ankuese të zhvillohet përmes tabelës së shpalljeve (i cili komunikim përcaktohet me nenin 114 të LPK-së) . Për këto arsye komisioni erdhi në përfundim se përmbaruesi lëndor nuk është përgjegjës në rastin konkret, për asnjërin nga shkeljet e përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, për arsye se të gjitha veprimet përmbarimore për rastin të cilin është paraqitur ankesa, janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPSDPLS.nr.12/2025 datë 30.09.2025

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Naim Meholli



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.